Numër: 01/281
Datë: 25.06.2021

Në mbështetje të neneve 6 dhe 16 të Ligjit Nr.03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare, si dhe Rregulloren Nr.01/2020 për përcaktimin e procedurave për aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), në mbledhjen e mbajtur me datë 25.06.2021 nxjerrë këtë:

VENDIM

I. **Refuzohet aplikacioni** i Institucionit për Aftësim Profesional "Illusion Academy", me adresë: Rruga "Lekë Dukagjini", në Komunën e Prishtinë, me kualifikimet: 1. Manikyr; 2. Grimer dhe 3. Parukeri.

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Institucioni i Aftësimit Profesional "Illusion Academy", me adresë: Rruga "Lekë Dukagjini", në Komunën e Prishtinë, ka aplikuar në AKK, për akreditim dhe validim të kualifikimeve: Manikyr; Grimer dhe Parukeri.

Me datë 01.06.2021, zyrtarja e AKK-së përmes emalit zyrtar drejtuar institucionit "Illusion Academy", ka kërkuar që në përputhje me paragrafin 3 të nenin 7 të Rregullores Nr.01/2020 për përcaktimin e procedurave për aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak, ta plotësoj aplikacionin dhe të njëjtin me përmirësimet e bëra ta dërgoj në AKK për vlerësim, përmirësimet e kërkuara nga AKK duhet të bëhen deri me datën 08.06.2021.

AKK në provat e lëndës nuk ka asnjë dëshmi se institucioni "Illusion Academy", ka bërë përmirësimet e kërkuara nga ekipi i ekspertëve të AKK-së, duke vepruar kështu në kundërshtim me afatin ligjor të përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 7 të Rregullores Nr.01/2020 për përcaktimin e procedurave për aplikim të Institucioneve të Arsimit dhe

Aftësimit Profesional, për proces të akreditimit institucional, validim dhe aprovim të kualifikimeve, si dhe për aplikim të institucioneve që zbatojnë Njohjen e Mësimit Paraprak.

Ekspertët e AKK-së duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi, kanë konstatuar se aplikacioni i institucionit "Illusion Academy" nuk është në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, kriteret dhe standardet e përcaktuara nga AKK, pasi që aplikacioni për validim dhe akreditim i institucionit "Illusion Academy" nuk është i nënshkruar, dhe se i njëjti duhet të nënshkruhen nga udhëheqësi i institucionit dhe koordinatori për sigurimin e cilësisë, rrjedhimisht nga kjo ekipi i ekspertëve i AKK-së i rekomandon Këshillit Drejtues të AKK-së që të refuzon aplikacionin e institucionit "Illusion Academy".

Rekomandimet përfundimtare të ekipit të ekspertëve janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara nga institucioni në fazën e aplikimit: Aplikacionin për validim të kualifikimit/modulit; Aplikacionin për akreditim si institucion ofrues dhe/ose vlerësues dhe lëshues të kualifikimit; Listë kontrolli për dokumentet e nevojshme për procesin e akreditimit dhe validimit nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), për Institucionet e Arsimit dhe Aftësimit Profesional (IAAP), Raporti i Vetëvlerësimit i institucionit "Illusion Academy", si dhe emali zyrtar i datës 01.06.2021.

Bazuar në këto rrethana, Këshilli Drejtues i AKK-së, lidhur me aplikacionin e institucionit "Illusion Academy", pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e AKK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesa për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 20, pika 1, 2, 3 dhe 4 e Udhëzimit Administrativ Nr. 35/2014, Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet KD të AKK, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. Institucioni i Aftësimit Profesional "Illusion Academy", dhe
2. Arkivit të AKK-së.

Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI

Kryetar KD së AKK